



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 339/4 prot

Datë 09.03.2022

V E N D I M

K.P.P. 229/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” SHPK në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-16799-12-30-2021, me objekt “Rikonstruksion rruge në lagjen “18 Tetori”, Engjëll Agalliu Ura Vajgurore Faza II (Rikualifikimi i rrugës Engjëll Agalliu)”, me fond limit 25,532,458.00 (njëzet e pesë milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK.

Ankimues:

“Avduli” SHPK

Lagjia”10 korrik”, rruga “Perlat Rexhepi”, objekt 3-katësh,
nr. 4, kati 1, Vlorë.

“ASI-2A CO” SHPK

Rruga Skënderbeu, Lagjja Bishanake, pallati nr. 18, hyrja
nr. 6, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Dimal

Rr. Dimal, L. “18 Tetori” Ura Vajgurore

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i
Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për
miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021,
datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për
Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit
Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimesi “Avduli” SHPK, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankimesi “ASI-2A CO” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.12.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-16799-12-30-2021, me objekt “Rikonstrukcion rruge në lagjen “18 Tetori”, Engjëll Agalliu Ura Vajgurore Faza II (Rikualifikimi i rrugës Engjëll Agalliu)”, me fond limit 25,532,458.00 (njëzet e pesë milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II.2. Në datën 17.01.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 03.02.2022, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me rezultatet si më poshtë:

- “Avduli” SHPK	18’271’725	I skualifikuar
- “L.T.E CONSTRUCTION”	18’637’844	I skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK	19’034’751	I skualifikuar
- “Beqiri” SHPK	20’248’190	I skualifikuar
- “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK	20’290’856	I skualifikuar
- “Shendelli” SHPK	21’947’964	I skualifikuar
- “KEG” SHPK	24’125’492	I skualifikuar

II.4. Në datën 03.02.2022 operatori ekonomik “Avduli” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon

- *Për mjetet dhe pajisjet që kërkohen të jenë në dispozicion sipas pikës 2.3.8 1. Në DST janë kërkuar 4 copë Vibrator betoni ndërsa OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.*
- *2. Në DST janë kërkuar 2 copë Gjeneratore, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.*
- *3. Në DST janë kërkuar 4 copë Matrapik, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.*

II.5. Në datën 03.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon

- Arsyet e skualifikimit:

1. Në kërkesat e DST OE duhet të disponojë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Objekti i kontratës tuaj “Thertore 1 Kat dhe Impiant Fotovoltarik dhe pajisje” që ju keni paraqitur nuk është i ngjashëm me objektin e kësaj procedure prokurimi.

2. Në kërkesat e DST OE duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave”. Ndërsa ju keni paraqitur licencë QKL me kodin III.2.B me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Transport i mbetjeve Inerte”.

II.6. Në datën 15.02.2022 është publikuar “Njoftimi i Anulimit” në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.7. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 23, më datë 21.02.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar “Njoftimi i Anulimit” për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 21.02.2022, operatori ekonomik “Avduli” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe në datën 18.02.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij. Gjithashtu, formulari i ankesës depozituar në KPP është i shoqëruar me dokumentacion provues, konkretisht fatura tatimore të njehsuara me origjinalin (të noterizuara).

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “Avduli” SHPK bazuar në pikën 2.3.8/a të DST që Bashkia Dimal publikoi, e cila sqaron se “Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”, ka deklaruar të gjitha mjetet e kërkuara në Formularin Përmbledhës së vetëdeklarimit dhe nuk ka ngarkuar dokumentet që disponon për mjetet dhe pajisjet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Pra, OE ka paraqitur në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit emrat e mjeteve dhe pajisjeve, me të dhëna për dokumentet e kërkuara bashkë me të dhënat e faturave, me anë të të cilave i disponon të gjitha mjetet dhe pajisjes e kërkuara në DST. Duke qenë se, synimi kryesor i vendosjes së kriterëve të veçanta është t’i lejoj autoritetit ekonomik njohjen e kapaciteteve të operatorit ekonomik, “Avduli” SHPK ka deklaruar të gjitha kriteret e vendosura nga Bashkia Dimal, duke i shoqëruar disa, në pikat ku kërkohej, me dokumentet përkatëse. Sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, “Avduli” SHPK, në pjesën e III, pika C, ka

deklaruar mjetet dhe pajisjet, duke vendosur në një rën anë emrin e mjetit ose pajisjet (jo duke e shoqëruar me numër) dhe në anën tjetër të dhënat e dokumenteve, me anë të të cilave vërtetohet disponimi i tyre. Sa i përket arsyeve që Bashkia Dimal e skualifikoi OE: Në faturat e paraqitura nga OE "Avduli" SHPK janë të gjitha pajisjet e kërkuara.

-Arsyeja e parë: Në DST janë kërkuar 4 copë Vibrator betoni ndërsa OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes "Vibrator betoni" janë deklaruar dy fatura:

1. Fatura nr. 164, datë 24.08.2021.

2. Fatura nr. 125, datë 20.02.2004. Në secilën faturë ndodhen 2 copë "Vibrator betoni" dhe së bashku bëjnë 4 copë duke plotësuar numrin e kërkuar në DST.

-Arsyeja e dytë: Në DST janë kërkuar 2 copë Gjenerator, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes "Gjenerator" është deklaruar një faturë.

1. Faturë nr. 22, datë 31.07.2003. Në faturë ndodhen 2 copë "Gjenerator" duke plotësuar numrin e kërkuar në DST.

-Arsyeja e tretë: Në DST janë kërkuar 4 copë Matrapikë, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes "Matrapik" janë deklaruar katër fatura:

1. Faturë nr. 08, datë 12.02.2015.

2. Faturë nr. 10, datë 21.10.2019.

3. Faturë nr. 27, datë 04.04.2000.

4. Faturë nr. 46, datë 19.08.2021.

Në secilën faturë ndodhen nga 1 copë "Matrapik" dhe së bashku bëjnë 4 copë duke plotësuar numrin e kërkuar në DST. Janë deklaruar të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga DST.

Autoriteti kontraktor Bashkia Dimal, nuk ka zbatuar me korrektësi procedurën dhe nuk ka ndjekur hapat që ligji parashikon për sqarimet në lidhje me dokumentet e paraqitura nga OE. Nuk ishte e nevojshme që operatori ekonomik të skualifikohej dhe të ndiqej rruga e ankimimit, në rast se autoriteti kontraktor do kishte garantuar zbatimin korrekt të procedurës dhe do të kishte kërkuar sqarim dhe dokumente mbështetëse në lidhje me shtojcën 8, në të cilën janë deklaruar të

gjitha emrat e pajisjeve dhe faturat përkatëse që plotësojnë numrin e kërkuar në DST. Fakti që nuk është vendosur numri anës emrit të pajisjes nuk do të thotë se ajo faturë mban vetëm një pajisje. Nga ana tjetër, vendosja e emrit dhe faturës, automatikisht lë të kuptohet që OE disponon mjetet e kërkuara duke mos përsëritur të dhënat e të njëjtës faturë dy apo më shumë herë. Për këtë arsye, Bashkia Dimal duhet të pranojë ankesën dhe të shpalli fituesin, konkretisht OE “Avduli” SHPK”.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 22.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Në ankesë ngrihen pretendime për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- *“Më poshtë po ju parashtrojmë faktet dhe argumentet: LIGJI NR. 162 DATE 23.12.2020 “PER PROKURIMIN PUBLIK”, Neni 77, Kërkesat për kualifikim, pika 4, Neni 79, VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, Neni 82 Shqyrtimi dhe Vlerësimi I ofertave i Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor, pika 4 , Neni 2 - Qëllimi . Kompania ASI-2A CO ShPK referuar 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale: Kapaciteti teknik: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”. ka paraqitur punë të ngjashme me objekt : Objekt Thertore 1 Kat dhe Impiant Fotovoltaik 150kË dhe pajisje. Sipas punës së ngjashme ne e kapim kriterin pasi brenda punimeve të këtij objekti janë bërë punime infrastrukturë, ujësjellësa-kanalizime, elektrike etj. Referuar situacionit Shuma 1 Punime dheu me vlerë 168, 520 lekë , Shuma 2 Punime Betoni dhe hekuri me vlerë 21,481,084 lekë , shuma 3 me vlerë 14,796,568 lekë , shuma 4 punime rrugë dhe sistemimi me vlerë 39,390,387 , Punime Elektrike shuma 6 me vlerë 290, 934 lekë. Theksojmë se brenda këtij situacioni janë të gjitha zërat e ngjashëm që edhe e tejkalojnë vlerën e punës së ngjashme që është kërkuar. Në këtë rast edhe pse objekti është objekt civil-industrial ka të përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizime, punimet elektrike dhe nuk mund të na skualifikoni për këtë pikë, pasi argumentimet tuaja nuk qëndrojnë. 2. 2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë licenca të*

vlefshme: Licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B të Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave, Kompania jonë disponon sipas Ligjit 10081 datë 23.02.2003 QKL III.2.B të Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave dhe argumenti i komisionit të vlerësimit të ofertave nuk qëndron”.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 339/2 Prot., date 21.02.2022, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Avduli” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 360/2 prot., datë 22.02.2022 me pretendime mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ASI-2A CO” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 536/5 prot., datë 23.02.2022, me lëndë “Informacion”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor sqaron se: “Pas përfundimit të vlerësimit nga Komisioni, operatori ekonomik “Avduli” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, e cila u shqyrtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të ngritur me urdhër të titullarit, sipas nenit 114 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Lidhur me kriteret e kualifikimit të kësaj procedure prokurimi, të parashikuara sipas pikës 2.3.8 në kërkesat e DST (për mjetet dhe pajisjet që kërkojnë të jenë në dispozicion), OE janë informuar se duhet të disponojnë:

1. Në DST janë kërkuar 4 copë Vibrator betoni ndërsa OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.
2. Në DST janë kërkuar 2 copë Gjeneratorë, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.
3. Në DST janë kërkuar 4 copë Matrapik, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Referuar kriterëve të cilat duhet të përmbushen, AK duhet ti përmbahet atyre me korrektësi sipas nenit 92, pika 3 të LPP. Po ashtu, lidhur me pretendimin e OE “Avduli” SHPK, për dorëzimin e faturës për të gjitha mjetet e kërkuara sipas DST-ve, por neni 82, pika 1 e ligjit citohet “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji...” ju informojmë se referuar LPP, operatori ekonomik nuk e ka dëshmuar paraprakisht zotërimin e të gjitha pajisjeve në Formularin Përmbledhës. OE në ankesën e drejtuar ndaj autoritetit

kontraktor shprehet se i disponon pajisjet dhe mjetet e përcaktuara në DST, por sipas ligjit të sipërcituar dhe mbi bazën e kriterëve të veçanta teknike të DST, të parashikuara për këtë procedurë prokurimi nuk e ka shprehur në formular numrin e saktë të mjeteve dhe pajisjeve, element ky i rëndësishëm për kualifikimin e një OE të suksesshëm. Për këto arsye Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazohet në ligj dhe OE i interesuar për këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar një formular përmbledhës me mangësi.

*Referuar ankesës së OE të sipërpërmendur, lidhur me procedurën e vlerësimit përfundimtar. Në mbështetje të neneve 111-114 të LPP, konstatojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka vendosur drejtë për skualifikimin tuaj. **Si e tillë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vendosi refuzimin e ankesës [...].***

II.9. Në datën 23.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK ka depozituar pranë protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, formular ankesa i protokolluar në nr. 360/3 prot., datë 23.02.2022, me të njëjtën objekt ankesë si në paraqitur ankesën e bërë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datën 22.02.2022.

II.10. Me shkresën nr. 607 prot, datë 24.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 360/4 prot., datë 02.03.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur **refuzimi i ankesës**. Autoriteti kontraktor sqaron se: “Ankesa e administruar pranë Bashkisë Dimal nr. 561 prot., datë 22.02.2022 i përmbush kriteret e cituara në nenin 111 të LPP dhe është paraqitur brenda afateve ligjore. Së bashku me ankimin është paraqitur dhe mandat pagesa e bërë pranë KPP. Për arsye të përmbushjes së kriterëve për paraqitjen e ankesave, autoriteti kontraktor vendosi për shqyrtimin e ankesës së paraqitur. Lidhur me kriteret e kualifikimit të kësaj procedure prokurimi, në kërkesat e DST OE duhet të disponojë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Po ashtu objekti i kontratës së OE “Thertore 1 kat dhe Impiant fotovoltaik” që kanë paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk është i ngjashëm me objektin e kësaj procedure prokurimi. Sipas DST, OE duhet të disponojë gjithashtu licencë III.2.B me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve Urbane dhe i mjeteve të dherave”. Sipas këtij kriteri të vendosur OE ka paraqitur licencë QKL me kodin III.2.B. me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Transport i mbetjeve Inerte”. Referuar ankesë së OE të sipërpërmendur, lidhur me procedurën e vlerësimit përfundimtar, në mbështetje të neneve 111-114 të LPP, konstatojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka vendosur drejtë për skualifikimin e tij. **Si e tillë, Titullari i autoritetit kontraktor, vendosi refuzimin e ankesës së OE “ASI-2A CO” SHPK**”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “**Avduli**” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: “[...]Operatori ekonomik “Avduli” SHPK bazuar në pikën 2.3.8/a të DST që Bashkia Dimal publikoi, e cila sqaron se “Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”, ka deklaruar të gjitha mjetet e kërkuara në Formularin Përmbledhës së vetëdeklarimit dhe nuk ka ngarkuar dokumentet që disponon për mjetet dhe pajisjet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Pra, OE ka paraqitur në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit emrat e mjeteve dhe pajisjeve, me të dhëna për dokumentet e kërkuara bashkë me të dhënat e faturave, me anë të të cilave i disponon të gjitha mjetet dhe pajisjes e kërkuara në DST. Duke qenë se, synimi kryesor i vendosjes së kriterëve të veçanta është t’i lejoj autoritetit ekonomik njohjen e kapaciteteve të operatorit ekonomik, “Avduli” SHPK ka deklaruar të gjitha kriteret e vendosura nga Bashkia Dimal, duke i shoqëruar disa, në pikat ku kërkohej, me dokumentet përkatëse. Sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, “Avduli” SHPK, në pjesën e III, pika C, ka deklaruar mjetet dhe pajisjet, duke vendosur në njërën anë emrin e mjetit ose pajisjet (jo duke e shoqëruar me numër) dhe në anën tjetër të dhënat e dokumenteve, me anë të të cilave vërtetohet disponimi i tyre. Sa i përket arsyeve që Bashkia Dimal e skualifikoi OE: Në faturat e paraqitura nga OE “Avduli” SHPK janë të gjitha pajisjet e kërkuara.

-Arsyeja e parë: Në DST janë kërkuar 4 copë Vibrator betoni ndërsa OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes “Vibrator betoni” janë deklaruar dy fatura:

1. Fatura nr. 164, datë 24.08.2021.

2.Fatura nr. 125, datë 20.02.2004. Në secilën faturë ndodhen 2 copë “Vibrator betoni” dhe së bashku bëjnë 4 copë duke plotësuar numrin e kërkuar në DST.

-Arsyeja e dytë: Në DST janë kërkuar 2 copë Gjenerator, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes “Gjenerator” është deklaruar një faturë.

1.Faturë nr. 22, datë 31.07.2003. Në faturë ndodhen 2 copë “Gjenerator” duke plotësuar numrin e kërkuar në DST.

-Arsyeja e tretë: Në DST janë kërkuar 4 copë Matrapikë, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pranë emrit të pajisjes “Matrapik” janë deklaruar katër fatura:

1.Faturë nr. 08, datë 12.02.2015.

2.faturë nr. 10, datë 21.10.2019.

3.Faturë nr. 27, datë 04.04.2000.

4.Faturë nr. 46, datë 19.08.2021.

Në secilën faturë ndodhen nga 1 copë “Matrapik” dhe së bashku bëjnë 4 copë duke plotësuar numrin e kërkuar në DST. Janë deklaruar të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga DST.

Autoriteti kontraktor Bashkia Dimal, nuk ka zbatuar me korrektësi procedurën dhe nuk ka ndjekur hapat që ligji parashikon për sqarimet në lidhje me dokumentet e paraqitura nga OE. Nuk ishte e nevojshme që operatori ekonomik të skualifikohej dhe të ndiqej rruga e ankimimit, në rast se autoriteti kontraktor do kishte garantuar zbatimin korrekt të procedurës dhe do të kishte kërkuar sqarim dhe dokumente mbështetëse në lidhje me shtojcën 8, në të cilën janë deklaruar të gjitha emrat e pajisjeve dhe faturat përkatëse që plotësojnë numrin e kërkuar në DST. Fakti që nuk është vendosur numri anës emrit të pajisjes nuk do të thotë se ajo faturë mban vetëm një pajisje. Nga ana tjetër, vendosja e emrit dhe faturës automatikisht lë të kuptohet që OE disponon mjetet e kërkuara duke mos përsëritur të dhënat e të njëjtës faturë dy apo më shumë herë. Për këtë arsye, Bashkia Dimal duhet të pranojë ankesën dhe të shpalli fituesin, konkretisht OE “Avduli” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.8, të dokumenteve të tenderit të publikuara në datën 31.12.2021 është kërkuar si vijon:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr.	Emri i mjetit	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës min 20 t	Copë 2 (dy)	Në pronësi ose me qira

2	<i>Kamionçinë vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 1-3 ton</i>	<i>copë (dy)</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
3	<i>Eskavator me goma</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
4	<i>Minifadroma</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
5	<i>Minieskavator</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
6	<i>Kamion me vinç</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
7	<i>Fadroma skrep</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
8	<i>Kantier ndërtimi (zyre)</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
9	<i>Panele armature betonimi</i>	<i>M2 300</i>		<i>Në pronësi ose me qira</i>
10.	<i>Vibrator betoni</i>	<i>copë (kater)</i>	4	<i>Në pronësi ose me qira</i>
11	<i>Pompe betoni</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
12	<i>GPS</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
13	<i>Prerëse Betoni</i>	<i>copë1 (nje)</i>		<i>Në pronësi ose me qira</i>
14	<i>Matrapik Hidraulik</i>	<i>copë (nje)</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
15	<i>Gjeneratorë</i>	<i>2 copë</i>		<i>Në pronësi ose me qira</i>
16	<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>		<i>Në pronësi ose me qira</i>
17	<i>Deflektometer për testimin e saldimit</i>	<i>copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>

		(nje)	
18	Asfaltoshtruese	copë (nje)	1 Në pronësi ose me qira
19	Grejder	copë (nje)	1 Në pronësi ose me qira
20	Rrul hekur-hekur	copë (nje)	1 Në pronësi ose me qira
21	Fabrike asfalti	copë (nje)	1 Në pronësi ose me qira /ose kontratë furinizimi
22	Fabrikë betoni	copë (nje)	1 Në pronësi ose me qira /ose kontratë furinizimi

a. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

-leja e qarkullimit;

-certifikatën e kontrollit teknik;

- siguracionin;

- fotot përkatëse;

ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

Për fabrikën e prodhimit të betonit dhe fabrikën e asfaltit

a) në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .

ose

b) në rast se është me qira duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat te vlefshme për realizimin e kontratës objekt-prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentet e kërkuara me sipër për fabrikën e prodhimit te betonit dhe asfaltit

ose

c) në rast të kontratës së furnizimit të paraqitet kontrata e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Avduli” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formularin e përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8).

III.1.3. Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e

këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;*

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.6. Konkretisht, referuar kriterit në lidhje me disponimin e mjeteve të kërkuara, konkretisht pika 2.3.8 *Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik*, ku ndër të tjera edhe mjete të tilla si: Vibrator betoni (4 copë), Gjenerator (2 copë) dhe Matrapik (4 copë), Komisioni konstaton se, për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke plotësuar edhe fushat përkatëse në (shtojca 8) në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas të dhënave që përmban ajo. Referuar kriterit të sipërcituar dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e

ofertuesit ankimues. Ndërkohë, arsyeja e skualifikimit të dhënë nga KVO lidhet me faktin se *Për mjetet dhe pajisjet që kërkohen të jenë në dispozicion sipas pikës 2.3.8:*

1. Në DST janë kërkuar 4 copë Vibrator betoni ndërsa OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.
2. Në DST janë kërkuar 2 copë Gjeneratorë, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë.
3. Në DST janë kërkuar 4 copë Matrapik, OE ka vetëdeklaruar vetëm 1 copë, KPP gjykon se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret tejkalon kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi autoriteti kontraktor nuk jep asnjë shpjegim se ku është bazuar, për të nxjerrë përfundimin se operatori ekonomik nuk disponon nga 4 (katër) pajisje Vibratorë Betoni, 2 (dy) copë pajisje Gjenerator dhe 4 (katër) copë pajisje Matrapik.

Nga verifikimi i dokumenteve shtesë bashkëlidhur ankesës operatori ekonomik në mbështetje të vetëdeklarimit mbi kapacitetin e disponimit të mjeteve ka paraqitur fakte dhe prova shpresore si Fatura Tatimore Shitje, konkretisht:

-Për “Vibrator betoni” janë deklaruar dy fatura:

1. Fatura nr. 164, datë 24.08.2021.
2. Fatura nr. 125, datë 20.02.2004.

-Për “Gjenerator” është deklaruar një faturë.

1. Faturë nr. 22, datë 31.07.2003.

-Për “Matrapik” janë deklaruar katër fatura:

1. Faturë nr. 08, datë 12.02.2015.
2. Faturë nr. 10, datë 21.10.2019.
3. Faturë nr. 27, datë 04.04.2000.
4. Faturë nr. 46, datë 19.08.2021.

Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, Komisioni konstaton, se në faturat nr. 164, datë 24.08.2021 dhe nr. 125, datë 20.02.2004, në secilën faturë ndodhen 2 copë pajisje “Vibrator betoni” dhe së bashku bëjnë 4 copë, duke plotësuar numrin e kërkuar në DST. Në Faturën nr. 22, datë 31.07.2003, ndodhen 2 copë pajisje “Gjenerator” duke plotësuar numrin e kërkuar në DST. Në faturat nr. 08, datë 12.02.2015, nr. 10, datë 21.10.2019, nr. 27, datë 04.04.2000 dhe nr. 46, datë 19.08.2021, në secilën faturë ndodhen nga 1 copë pajisje “Matrapik” dhe së bashku bëjnë 4 copë duke plotësuar numrin e kërkuar në DST. Nga verifikimi i të dhënave në dokumentacionin e dorëzuar provues (të noterizuar) dhe të dhënave të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Komisioni konstatoi se, janë deklaruar pajisjet konkretisht në rastin konkret për: 4 (katër) pajisje Vibratorë Betoni, 2 (dy) copë pajisje

Gjenerator dhe 4 (katër) copë pajisje Matrapik sipas kriterit të kërkuar në pikën 2.3.8 të dokumenteve të tenderit.

Nga shqyrtimi dhe informacioni për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të këtë bërë një hetim apo verifikim për disponimin e pajisjeve bazuar në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik ofertues, pasi referuar nenit 26/7 të VKM Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e veçantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Gjithashtu referuar edhe nenit 26/6 të VKM Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”, si dhe ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të parë të sjellë dokumentacionin provues, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, përpara se të publikojë në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit apo anulimit, me qëllim verifikimin e të dhënave të deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar në rrugë elektronike, me dokumentimin e tyre me dokumentacion provues, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës. Me publikimin e njoftimit të fituesit ose anulimit, në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të LPP. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

originalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se nga kryqëzimi i të dhënave të plotësuara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit me ato të dokumentacionit provues të paraqitur në formularin e ankesës nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, ankimuesi plotëson kërkesat e kriterëve të kualifikimit për disponimin e pajisjeve të përcaktuara në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. Referuar kriterit të sipërcituar dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e ofertuesit ankimues. Gjithashtu, KPP sjellë në vëmendje të autoritetit kontraktor zbatimin e këtij konstatimi, edhe në zhvillimin e procedurave të prokurimit në të ardhmen.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Avduli” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “**ASI-2A CO**” SHPK, Komisioni konstaton se,

Në datën 31.12.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-16799-12-30-2021, me objekt “Rikonstruksion rruge në lagjen "18 Tetori", Engjëll Agalliu Ura Vajgurore Faza II (Rikualifikimi i rrugës Engjëll Agalliu)”, me fond limit 25,532,458.00 (njëzet e pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

III.2.1. Në datën 17.01.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 03.02.2022, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me rezultatet si më poshtë:

- “Avduli” SHPK	18’271’725	I skualifikuar
- “L.T.E CONSTRUCTION”	18’637’844	I skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK	19’034’751	I skualifikuar
- “Beqiri” SHPK	20’248’190	I skualifikuar
- “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK	20’290’856	I skualifikuar
- “Shendelli” SHPK	21’947’964	I skualifikuar
- “KEG” SHPK	24’125’492	I skualifikuar

III.2.3. Në datën 03.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

- Arsyet e skualifikimit:

1. Në kërkesat e DST OE duhet të disponojë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Objekti i kontratës tuaj ”Thertore 1 Kat dhe Impiant Fotovoltarik dhe pajisje” që ju keni paraqitur nuk është i ngjashëm me objektin e kësaj procedure prokurimi.

2. Në kërkesat e DST OE duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “ Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave”. Ndërsa ju keni paraqitur licencë QKL me kodin III.2.B me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Transport i mbetjeve Inerte”.

III.2.4. Në datën 15.02.2022 është publikuar “Njoftimi i Anulimit” në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

III.2.5. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 23, më datë 21.02.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 22.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK, ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Në ankesë ngrihen pretendime për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- *“Në datën 15.02.2022 është shpallur njoftimi për anulim të procedurës pasi asnjë nga ofertat nuk është e përshtatshme në procedurat me një fazë.*

Më poshtë po ju parashtrojmë faktet dhe argumentet: LIGJI NR. 162 DATE 23.12.2020 “PER PROKURIMIN PUBLIK”, Neni 77, Kërkesat për kualifikim, pika 4, Neni 79, VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” , Neni 82 Shqyrtimi dhe Vlerësimi I ofertave të Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor, pika 4 , Neni 2 - Qëllimi . Kompania ASI-2A CO ShPK referuar 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale: Kapaciteti teknik: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,

nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”. ka paraqitur punë të ngjashme me objekt : Objekt Thertore 1 Kat dhe Impiant Fotovoltaik 150kË dhe pajisje. Sipas punës së ngjashme ne e kapim kriterin pasi brenda punimeve të këtij objekti janë bërë punime infrastrukturë, ujësjellësa-kanalizime, elektrike etj. Referuar situacionit Shuma 1 Punime dheu me vlerë 168, 520 lekë , Shuma 2 Punime Betoni dhe hekuri me vlerë 21,481,084 lekë , shuma 3 me vlerë 14,796,568 lekë , shuma 4 punime rrugë dhe sistemimi me vlerë 39,390,387 , Punime Elektrike shuma 6 me vlerë 290, 934 lekë. Theksojmë se brenda këtij situacioni janë të gjitha zërat e ngjashëm që edhe e tejkalojnë vlerën e punës së ngjashme që është kërkuar. Në këtë rast edhe pse objekti është objekt civil-industrial ka të përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizime, punimet elektrike dhe nuk mund të na skualifikoni për këtë pikë, pasi argumentimet tuaja nuk qëndrojnë. 2. 2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë licenca të vlefshme: Licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B à Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave, Kompania jonë disponon sipas Ligjit 10081 datë 23.02.2003 QKL III.2.B à Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane dhe i mbetjeve të dherave dhe argumenti i komisionit të vlerësimit të ofertave nuk qëndron”.

III.2.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 360/2 prot., datë 22.02.2022 me pretendime mbi arsyet e skualifikimit.

III.2.8. Në datën 23.02.2022 operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK ka depozituar pranë protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, formular ankese protokolluar në nr. 360/3 prot., datë 23.02.2022, me të njëjtin objekt-ankesë si në ankesën e bërë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datën 22.02.2022.

III.2.9. Me shkresën nr. 607 prot, datë 24.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 360/4 prot., datë 02.03.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ASI-2A

CO” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur **refuzimi i ankesës**.

III.2.10. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “**2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimin të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.2.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga **publikimi i njoftimit të fituesit** ose i **njoftimit të anulimit**. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik u konstatua, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar “Njoftimi i Anulimit” në datën 15.02.2022 dhe publikimi i këtij të fundit në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 23, me datë 21.02.2022, ndërkohë që për këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik ankimues, ka dorëzuar ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në datën 22.02.2022, si dhe po të njëjtën ankesë të depozituar në datë 23.02.2022 në protokollin me nr. 360/3 datë 23.02.2022. Gjithashtu, vetë operatori ekonomik ankimues “ASI-2A CO” SHPK, ka pranuar në Formular Ankese, që është njoftuar mbi “Njoftimin e Anulimit” të kësaj procedure objekt-ankimi, duke cituar se: “Në datën 15.02.2022 është shpallur njoftimi për anulim të procedurës pasi asnjë nga ofertat nuk është e përshtatshme në procedurat me një fazë”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2.Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose Anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik është data 21.02.2022. Për sa më sipër, ankesa e depozituar në Sistemin e Ankesave Elektronike në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 22.02.2022, si dhe

ankesa e depozituar më datë 23.02.2022 në protokollin me nr. 360/3 datë 23.02.2022, konsiderohet e paraqitur pas afatit të fundit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. **Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Jo më kot, ligjvënësi në pikën 8 të nenit 110 të LPP ka parashikuar, që ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, pra ligji i posaçëm prevalon mbi ligjin e përgjithshëm. Rregullimi i afateve të ankimimit në këtë rast bëhet me anë të ligjit të posaçëm dhe kjo vendimmarrje është e konsoliduar nga Komisioni i Prokurimit Publik.**

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik ka përfunduar dhe ka vënë në zbatim sistemin e ri elektronik të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave, lidhur me procedurat e prokurimit publik, leje minerare, ankand, koncesion/ppp. Ky sistem nëpërmjet portalit e-albania ofron shërbimet elektronike për operatorët ekonomikë përkatësisht: *1-Ankesë* për procedurat e prokurimit publik, leje minerare, ankand ose koncesion/ppp dhe *2-Argument* për procedurat e lartpërmendura, shërbime të cilat ofrohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, për t’iu ardhur në ndihmë dhe duke iu kursyer kohë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi në depozitimin brenda afateve të ankimimit, të formularit të ankesave, njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-16799-12-30-2021, me objekt “Rikonstrukcion rruge në lagjen "18 Tetori", Engjëll Agalliu Ura Vajgurore Faza II (Rikualifikimi i rrugës Engjëll Agalliu)”, me fond limit 25,532,458.00 (njëzet e pesë milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.01.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Avduli” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Avduli” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

